# Komuna Kallmet
# Paketa fiskale 2014-2016

Dokumenti është hartuar me asistencën e ISB, Instituti i Studimeve Bashkohore, financuar nga Programi dldp-II

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QARKU LEZHE
KESHILLI I KOMUNES KALLMET

Adresa: Kallmet Lezhe E- mail: petritmarku@hotmail.com

# RELACION

## PAKETA FISKALE 2014-2016

Tetor 2013

# Përmbajtja


A MBI KOMUNËN KALLMET 4
Hartimi i paketës fiskale 2014-2016 6
Baza ligjore 7
Çfarë prezanton paketa fiskale 2014-2016 9

B. PAKETA FISKALE 2014-2016 14

KAPITULLI I: BAZA LIGJORE 14

KAPITULLI II: TAKSAT VENDORE 16
II.1 TAKSA MBI PASURITE E PALUAJTSHME 16
II.1.1 Taksa mbi ndërtesën; 17
II.1.2 Taksa mbi tokën bujqësore. 19
II.2 TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL 20
II.3 TAKSA E FJETJES NE HOTEL 21
II.4 TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA 21
II.5 TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME 22
II.6 TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA. 23
II.7 TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE 23
II.8 TAKSA E TABELES 25

KAPITULLI III: TARIFAT VENDORE 27
III.1 TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE 27
III.2 TARIFA E PARKIMIT TE AUTOMJETEVE 28
III.3 TARIFA PËR SHËRBIME PUBLIKE 29
III.4 TARIFA E UJIT 30
III.5 TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË KOMUNËS KALLMET 31
III.5.1 Tarifa të urbanistikës 31
III.5.2 TARIFA TË SHËRBIMIT VETERINER 31
III.5.3 TARIFA PER SHERBIMIN NE FUSHEN E TRANSPORTIT TE PASAGJEREVE DHE MALLRAVE, DHENIEN E LEJEVE PER USHTRIM AKTIVITETI 32
III.5.4 TARIFA TË TJERA 32

KAPITULLI IV GJOBA 33

KAPITULLI V ANEKSE 35
Aneksi Nr.1 Taksa e biznesit të vogël 35
Aneksi Nr.2 Tarifa e Pastrimit dhe largimit te mbeturinave 37
Aneksin Nr.3. Tarifa për shërbime publike 41
Aneksi Nr.4 Shpjegimi i termave 44

# A Mbi Komunën Kallmet

Burimet e financimit të Komunës Kallmet përbëhen prej te ardhurave nga taksat e tarifat vendore, donacione, te ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhura nga transferta e kushtëzuar, fonde te cilat nuk raportohen në buxhetin e komunës.

Pavarësisht ndryshimeve ligjore të finalizuara deri në vitin 2009 Komuna Kallmet ka forcuar vazhdimisht kapacitetet administrative për të minimizuar efektin e këtyre ndërhyrjeve duke u përpjekur në rritjen e bazës së taksapaguesve dhe arkëtimin në nivle të kënaqshëm të të ardhruave nga të gjitha burimet.

Kapacitetet financiare të kufizuara përbën një nga sfidat e komunës në vazhdim për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e komunitetit të cilat janë vazhdimisht në rritje. Si rezultat një planifikim dhe mobilizim i kujdesshëm do të vihet në zbatim me qëllim zbatimin e investimeve publike të nevojshme për komunën dhe komunitetin vendas.

Ndërkohë fuqizimi i kapaciteteve zhvilluese të komunës në vijim dhe aplikimi i instrumentave të nevojshmë financiarë për përmirësimin e performancës fiskale do të ndihmojnë në thithjen e më shumë fondeve dhe rritjes së të ardhurave vendore për zbatimin e projekteve.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur një rritje progresive në trendin e të ardhurave jo vetëm si rezultat i ndryshimit të legjislacionit fiskal por edhe si rezultat i përmirësimit të treguesve të administrimit të sistemit fiskal të Komunës.

Kështu të ardhurat nga Taksat dhe Tarifat në vitin 2009 janë rritur rreth 48%, krahasuar me vitin 2008 duke ndjekur me tej një trend në rritje deri në vitin 2011 ku këto të ardhura u rritën me 55%.

**Tabela nr. 1: Parashikimi i të ardhurave të veta për vitet 2013-2015**

| Te ardhurat | Fakti '11 | Plani '12 | fakti '12 | Plani '13 | Plani '14 | Plani '15 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Taksat vendore | 2,261 | 4,500 | 3,667 | 5,500 | 5,800 | 6 300 |
| Tarifat vendore | 1,334 | 3,100 | 1,902 | 3,600 | 3,800 | 3,800 |
| Të tjera | 64 | 400 | 60 | 400 | 400 | 400 |
| **Shuma** | **3,659** | **8,000** | **5,629** | **9,500** | **10 000** | **10 500** |
| Të mbartura | 191 | 303 | 303 | 920 | - | - |
| **Gjithsej** | **3,850** | **8,303** | **5,932** | **10,420** | **10 000** | **10 500** |

Për vitin 2012 të ardhurat parashikohet të realizohen në masën 90% ndaj planit. Për vitin 2013, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore, janë parashikuar të jenë 9,500 leke dmth 18.7 % më shumë se plani i vitit 2012, për vitin 2014 të jenë 4.2 % më pak se viti i mëparshëm dhe për vitin 2015 do të jenë 5 % me shume se ato te vitit 2014.

**Analiza e fuqive dhe dobësive të Komunës Kallmet**

| Fuqitë | Dobësitë |
| --- | --- |
| – Rritja e potencialit fiskal nëpërmjet orientimit drejt agroturizmit;<br>– Vëmëndje më e larte drejt politikave fiskale dhe rritjes së bazës së taksapaguesve<br>– Ngritja e zyrës me një ndalesë ka ndikuar në rritjen e performancën fiskale të Komunës;<br>– Instalimi dhe aplikimi i programit të taksave, ka ndikuar pozitivisht në rritjen e bazës së taksapaguesve dhe mirëadministrimin e taksave/tarifave.<br>– Hartimi i planit të manaxhimit të mbetjeve do të ndikojë në mirëllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe mbulimin e kostove;<br>– Hartimi i paketës fiskale me një projeksion 3 vjecar;<br>– Miratimi i planit strategjik.<br>– Hartimi i PBA 2014-2016. | – Mungon hartimi i paketës fiskale me pjesëmarrje.<br>– Marrëdhëniet ndërinstitucionale;<br>– Strukturat e qarta tatimore;<br>– Parashikimet e të ardhurave nuk janë realiste;<br>– Mungojnë politikat fiskale të mirëfillta në drejtim të përcaktimit qartazi të kategorive taksapaguese, llojit të aktivitetit, xhiros, elementëve sociale, elementëve turiztikë etj;<br>– Administrimi i taksave dhe vjelja e detyrimeve;<br>– Ka ende nevojë për unifikimin e të dhënave dhe programit të taksave mbasi komuna punon me dy programe.<br>– Kontabilizimi i të ardhurave<br>– Arkëtimet janë shumë të ulta krahasuar me parashikimet dhe potencialin fiscal.<br>– Mungon një përllogaritje e potencialit fiskal;<br>– Mungon Manaxhimi i riskut. |

## Hartimi i paketës fiskale 2014-2016

Komuna Kallmet e konsideron si prioritet rritjen e nivelit dhe cilësisë së shërbimeve publike që u ofrohen banorëve të saj, por realizimi i këtij objektivi madhor kërkon domosdoshmërisht edhe burimet financiare të cilat sigurohen nga të ardhurat e veta, të ardhura të cilat kanë ardhur në rritje fale kjo dhe mirëadministrimit të burimeve nga vetë adminstrata e komunes.

Duke analizur ecurinë e realizimit të te ardhurave të Komunës në vitet e fundit, rezulton se këto burime janë rritur vazhdimisht por njëkohësisht ekzistojnë burime që duhen shfrytëzuar më mirë nga njësitë e qeverisjes vendore.

Hartimi i paketës fiskale përbën një nga objektivat më të rëndësishëm të Komunës Kallmet, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritare të identifikuara në Planin Strategjik të Zhvillimit Vendor 2011-2015 dhe programin buxhetor afatmesëm 2014-2016 të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor dhe zbatimin e buxhetit.

Nisur nga ky fakt, unë si Kryetar i Komunës, së bashku me strukturat e saj, kemi përgatitur disa propozime për sistemin e taksave dhe tarifave që do të zbatojë Komuna Kallmet për një periudhë 3 vjecare, periudhë e cila përkon dhe me strategjinë e zhvillimit të Komunës miratuar në vitin 2012 si dhe me programin Buxhetor Afamesëm 2014-2016.

Këto propozime konsistojnë në përmirësimin e aspektit procedural dhe teknik që lidhen me aplikimin e paketes fiskale e më konkretisht:

a) Rishikimi i kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe cdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura;
b) Saktësimi i procedurave, afateve, aktorët, veprimeve, përgjegjësive për çdo taksë dhe tarifë pjesë e saj. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal efiçent dhe transparent.
c) Përcaktimi i qartë dhe ndarja në seksione e taksave nga tarifat. Cdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementë:

    - Klasifikimi i biznesit, xhiro, lloji i aktivitetit;
    - Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;

d) Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji; Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;
e) Analzia e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;
f) Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, bështetur kjo në PSZH të komunës por dhe në Strategjinë e përfshirjes sociale dhe grupeve që përcaktohen në të.

## Baza ligjore

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor, dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në të ardhurat vendore përfshihen:

- Taksa e biznesit të vogël;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- Taksa e përvitshme e pasurisë për tokën bujqësore;
- Taksa e përvitshme e pasurisë për ndërtesat;
- Taksa (e përbashkët) për transferimin e pasurisë së patundshme;
- Taksa (e përbashkët) për automjetet/mjetet e përdorura;
- Taksa e zënies së hapësirave publike;
- Taksa e tabelës/reklamat;
- Taksa të përkohshme;
- Tarifa për shërbime (më e rëndësishmja tarifa e pastrimit).

Që nga miratimi i tij ligji (9632) i sipërcituar ka pësuar shumë ndryshime, të cilat kanë ndikuar në aftësinë e njësive vendore për të shfrytëzuar më së miri dhe në autoritet të plotë taksat dhe tarifat vendore. Kryesisht këto ndryshime konsistojnë në:

- Reduktimin në masën 70% diskrecionin fiskal të njësive vendore (duke çuar kufijtë minimal dhe maksimal të taksës nga +/-30% në +/-10%);
- Kufizime në lidhje me vendosjen e tarifave (për të cilat vetë ligji kuadër nuk njeh koncept tjetër të kufizimit të tarifave veç se nivelin e tyre, deri në nivelin e kostove për të mbuluar shërbimin publik të ofruar), duke kufizuar të ardhurat nga tarifat me 90%, ose deri në 10% të nivelit të të ardhurave nga taksa; dhe
- Kufizon të ardhurat nga taksat e përkohshme, deri në 10% të nivelit të taksës së biznesit të vogël.
- Reduktimin e taksës së tabelës.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor.

**Ligje:**

- Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 9931. date 09.06.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr .9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 10073, datë 09.02.2009 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 10117, datë 23.04.2009, "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar", Ligji nr. 10146, datë 28.9.2009, "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar", Ligji nr. 10354, datë 18.11.2010, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Ligji nr. 10457, datë 21.07.2011 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".
- Ligji nr.9161, datë 18.12.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat " i ndryshuar, Ligji nr.9326, datë 6.12.2004 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar"

- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar”.
- Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, ”Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr.10280, datë 20.5.2010, ”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar”, Ligj nr.10458, datë 21.7.2011, ”Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, date 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”.

**Vendime dhe udhëzime:**

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2007 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, ”Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”
- Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore “
- Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”
- Udhëzimi i Ministrit të Financave, nr. 18, datë 23.08.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar”

## Çfarë prezanton paketa fiskale 2014-2016

Me miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 dhe në mënyrë të veçantë të Ligjit organik Nr. 8652, dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", decentralizimi është konsideruar jo vetëm si një angazhim i rëndësishëm kushtetues e ligjor, por edhe si një proçes që i hap rrugën perspektivave të zhvillimit vendor dhe rajonal dhe që bën të mundur përafrimin me kërkesat dhe standartet e asocimit dhe antarësimit në Bashkimin Evropian.

Në këto kushte, një sërë ligjesh e aktesh nënligjore sektoriale janë miratuar dhe disa të tjerë janë në proces. Ky proces përfshin kalimin e funksioneve e përgjegjësive të rëndësishme për jetën publike e komunitare në njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna dhe qarqe), të tilla si infrastruktura publike, planifikimi, zhvillimi dhe menaxhimi urban, shërbimet me karakter social e zbutja e varfërisë, strehimi, kultura, arsimi parauniversitar, zhvillimi ekonomiko-vendor dhe i biznesit, fusha fiskale etj.

Miratimi i Ligjit Nr.9632, dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ofroi një fazë të rëndësishme të reformës së decentralizimit fiskal që sanksionoi autonomi më të madhe të bashkive dhe të komunave për të përcaktuar burimet e të ardhurave të veta vendore dhe nivelet e tyre. Kjo gjithashtu solli një rritje të kapacitetit lokal për të siguruar mbledhje më efikase të të ardhurave, të përgjegjësisë dhe autonomisë për mbledhjen e këtyre të ardhurave, mbështetur në nevojat dhe prioritetet e zhvillimit vendor të qytetit.

Bazuar në kopetencën për vendosjen e nivelit të taksës, brenda kufijve të me ligj si dhe në kompetencat e bërjes së politikës së mbulimit të kostos së tarifave të shërbimit i paraqesim Këshillit të Komunës të miratojë nivelet konkrete të taksave dhe tarifave që do të aplikohen në Komunën Kallmet, duke synuar nje vijueshmëri të sistemit të mëparshëm të taksave në sistemin e ri, pa shumë ndryshime dhe rritje të ndjeshme të nivelit të tyre, madje duke aplikuar edhe uljen e nivelit të taksës në -30 %, nën nivelin tregues të përcaktuar me Ligj.

Pamvarësisht nga përmirësimet dhe të rejat e sjella, paketa fiskale duhet të mbetet në një proçes reformativ të vazhdueshëm, i cili diktohet nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm ku përmendim :

**Faktorë të jashtëm:**

- Marrja e funsioneve dhe përgjegjësive të reja;
- Aplikimi i normave të inflacionit;
- Ndikimit të politikave qëndrore ndaj atyre lokale (legjislacioni fiskal i miratuar, shpërndjarja e grantit etj).

**Faktorë të brëndshëm:**

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit.
- Njohja më e mirë e territorit dhe e ekonomisë vendore
- Krijimi i strategjive, politika afat-mesme, afat-gjata
- Përmirësimin e elementëve të administrimit tatimor. etj

Krahas rritjes të të ardhurave, eksperienca tregon se niveli i taksave i vendosur me ligj është fiks dhe nuk merr në konsideratë rritjen e kostos së shërbimeve, si rrjedhojë e inflacionit, apo efektet e jashtme nga rritja e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore etj. Për keto arsye, si dhe nisur nga realiteti që kostoja e shërbimeve dhe standartet e kryerjes së tyre janë rritur, na kushtëzon për të propozuar paketën e re fiskale si ndryshime te dukshme nga ajo ekzistuese e

miratuar me VKB 5 Date 13.01.2012, e cila do te jap efektet në vitin 2014-2016 dhe ne vitet ne vijim.

**Propozimet për paketën e re fiskale 2014-2016 konsistojnë si më poshtë:**

**A. Riklasifikime të taksave dhe tarifave ekzisuese, prezantimi i tarifave të reja, përcaktimi i qartë i llojit të taksave/tarifave, baza e taksueshem, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.**

a) **Riklasifikimi i disa nenkategorive për disa taksa dhe tarifave,** në përputhje me klasifikimet e biznesit te vogël. Ndryshimet e pasqyruara ne ketë material, lidhur me **taksën e biznesit te vogël,** konsistojnë në riklasifikimin dhe kategorizimin e niveleve dhe emërtimeve të aktiviteteve për cdo kategori apo grupim të përcaktuar me ligj.

b) **Unifikimin e kategorive** dhe për taksat e tarifat e tjera vendore, si për shembull tarifa e pastrimit dhe ajo e shërbimeve publike;

c) **Taksa e biznesit të vogël** do të jetë në nivelin e paketës së vitit 2012.

d) **Rikategorizimi i taksës së ndërtesës sipas të gjitha kategorive,** detajimi i nivelit të taksës dhe plotësimi me të gjitha spjegimet mbi kategoritë objekt të kësaj takse. Aplikimi i zbritjeve për taksapaguesit të cilët paguajnë të gjithë vlerën e detyrimit tatimor vjetor brenda datës 20 Prill, duke përfituar si kusht lehtësues reduktimin në masën prej 6 % të vlerës së detyrimit.

e) **Rikategorizimi i taksës mbi tokën bujqësore.**
Aplikimi i zbritjeve në masën 30% nga niveli i përcaktuar në ligj, (maksimumi i lejueshëm).

- Është **rikonceptuar mënyra e pagesës**, kështu detyrimi për taksën mbi tokën është vjetor. Ky detyrim ndahet në 2 këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill, Kësti i dytë paguhet brenda datës 20 Qershor.
- Aplikimi i **lehtësive tatimore** sic janë përjashtimet nga taksa e tokës bujqësore,
    - Invalidët e punës e të luftës;
    - Të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si individë;
    - Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes

f) **Rikonceptimi i tarifës së pastrimit e më konkretisht ndërhyrja konsiston në:**

- Riahpërndarje e barrës fiskale për të gjitha kategoritë, duke ju përmbajtur konceptit që kush ndot më shumë paguan më shumë. Rritje e nivelit të kësaj tarife për kategorinë e familjarëve dhe biznesit duke ju përafruar kostos së shërbimit; Në llogaritjen e tarifimit kemi marrë për bazë të dhënat e mëposhtëme:
- Numri i banorëve, familjeve, kosto vjetore që njësia vendore duhet të mbulojë për shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave. Kështu mbështetur në analizën tonë vërejmë se kategoria e familjarëve zë 90% të kostos së pastrimit, ndërkohë që biznesi vetëm 10%. Në supozimin tonë kemi përjashtuar kategoritë në nevojë të cilët përbëjnë vetëm 3%.
- Një projeksion të nivelit të kësaj takse për një periudhë 3 vjecare.
- Gjithashtu janë riparë nivelet dhe kategorizimet e taksës duke shtuar kategorinë VIP (subjektet me të ardhurat më të mëdha).
- Janë përjashtuar nga tarifa e pastrimit kategoritë në nevojë sic janë: invalidët, PAK etj;

- Edhe për këtë tarifë ashtu si për të gjitha taksat dhe tarifat është prezantuar koncepti i pagesës së detyrimit të subjektit deri në momentin e ushtrimit të aktivitetit, si dhe rimburësimin e këtyre pagesave nëse ato janë paguar.

g) **Rikonceptimi i tarifës së parkimit për të gjitha automjetet duke shtuar për herë të parë dhe ato taksi.** Duke qenë se taksitë por dhe automjetet e tjera jane kontrollohen nga komuna si për nivelin e tarifes qe aplikojne ashtu dhe per vendparkimet e vendosura per to eshte pare e arsyeshme qe per keto kategori mjetesh te krijohen lehtësira mbi pagesn e parkimit te tyre duke rivendosur nivelin e kesaj tarife vetem per keto mjete ne nivelin e miratuara me pare nga keshilli bashkiak ne ore sipas kontrates se lidhur per ketë qellim me subjektet diusponuese te ketyre mjeteve.

- Për subjektet që kërkojnë parkim të rezervuar pranë institucioneve të tyre publike ose private tarifa përllogaritet duke shumëzuar vlerën sipas zonës së parkimit për rezervim 12 mujor. Në këtë kusht lehtësues përfshihen edhe taksitë 4+1.

h) **Aplikimi për herë të parë i tarifës për shërbimet publike**. Kjo tarifë do të përmbledhë tariën e ndricimit, gjelbërimit dhe shërbimeve në infrastrukturën rrugore.

- Kjo tarifë do të aplikohet për të gjithë familjet dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet dhe do të prezantohet me një projeksion 3 vjecar, qëllimi në këtë kalkulim është përafrimit i kostos së shërbimit po ashtu dhe për bizneset.
- Janë përjashtuar nga tarifa e për shërbimet publike të gjitha kategoritë në nevojë sic janë: invalidët, PAK etj;
- Janë marrë për bazë në këtë formulim të tarifës, numri i banorëve, familjeve, kosto vjetore që njësia vendore duhet të mbulojë për këto shërbime. Kështu mbështetur në analizën tonë vërejmë se kategoria e familjarëve zë mbi 90% të kostos së shërbimit, ndërkohë që biznesi rreth 10%. Në supozimin tonë kemi përjashtuar kategoritë në nevojë të cilët përbëjnë vetëm 3%.
- Edhe për këtë tarifë ashtu si për të gjitha taksat dhe tarifat është prezantuar koncepti i pagesës së detyrimit të subjektit deri në momentin e ushtrimit të aktivitetit, si dhe rimburësimin e këtyre pagesave nëse ato janë paguar.

i) **Taksa e fjetjes në hotel** do të pësojë në ulje për vitin 2014 në masën 30% për të vijuar më tej në vitet në vijim në nivelin 5%.

- Kjo politikë do të ndiqet me qëllim favorizimin e këtij biznesi I cili është I lidhur dhe me turizmin kulturor që ofron Komuna.

j) **Rikategorizmi dhe formulimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë.** Tashmë kjo taksë prezantohet në një format të ri ku janë detajuar të gjitha llojet e ndërtesave, gjithashtu janë aplikuar dhe ulje të nivelit për kategori të caktuara si psh:

- Objekte banimi, administrative, shërbimi etj.
- Objekte për qëllime publike kopshte, çerdhe, shkolla, spitale
- (private dhe shtetërore)
- Infrastrukturë (private dhe shtetërore ) si : rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefoni etj Për ndërtesat në proces legalizimi

**Janë aplikuar dhe lehtësira tatimore** si më poshtë:

- Në rastet kur investitor është Komuna, kjo taksë nuk aplikohet.
- Përjashtimisht për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar.
- Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

k) **Rikategorizmi dhe formulimi i taksës së zënies së hapsirave publike si psh:**

- Organizimin e spektakleve ose panaireve të ndryshme
- Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi/tregtimi në Tregjet Publike të administruara nga Komuna Kallmet;
- Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si: vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma , sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to, sipërfaqe të zëna me antena televizive dhe telefoni, gabina elektrike, nënëstacione, fusha sportive, varreza makinash, pishina etj të kësaj natyre, cadra fushimi, rulota etj të ngjashme me to.
- Ripërcaktimi i lehtësirave tatimore por dhe i rregullave për shfrytëzimin e hapsirave publike.

l) **Rikategorizmi dhe formulimi i taksës së tabelës,** mbështetur dhe në specifikat e ndryshimeve ligjore duke patur në konsideratë dhe saktësuar mirë kategorizmimet dhe dallimin midis:

- Tabelë për qëllime identifikimi nga Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.
- Janë përcaktuar qartë kriteret dhe lehtësirat tatimore.

m) **Rikategorizimi dhe detajimi I tarifave të shërbimit administrativ të komunës kallmet.** Janë specifikuar të gjitha llojet e tarifave dhe strukturat përgjegjëse për vendosjen dhe vjeljet e tyre.

n) **Aplikimi i gjobave.** Janë përcaktuar për herë të parë si pjesë e një paketë dhe gjobat për të gjitha shkeljet/kundravajtjet që mund të bëhen nga bizneset apo familjarët.

**B. Është prezantuar koncepti i pagesës së detyrimit të subjektit deri në momentin e ushtrimit të aktivitetit, si dhe rimburësimi i këtyre pagesave nëse ato janë kryer.**

**C. Ulje të nivelit të taksave dhe tarifave ekzistuese.**

- Zbatimi ne vijimësi i politikave të komunës për lehtësirat fiskale mbi zbritjen e shumës së detyrimit për subjektet që paguajnë detyrimet para afatit të përcaktuar.
- Lehtësimi ose përjashtimi nga pagesa për tarifën e pastrimit, nga disa kategori taksapaguesish (invalid, veteran, përfitues të ndihmës ekonomike, të verbër)

**D. Përmirësime në drejtim të mirëadministrimit të Taksave dhe Tarifave Vendore.**

- Lehtësi në përllogaritjen e detyrimit në mbështetje të muajve të ushtrimit të aktivitetit dhe standartizim i administrimit të taksave dhe tarifave vendore në tërësi.

- Përcaktimi i afateve kohohre, mënyrës së pagesës, agjentët fiskale apo dhe lehtësitë fiskale.
- Rritja e numrit të kësteve të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për kategoritë e familjarëve në 2 me qëllim lehtësimin e  barrës fiskale të taksapaguesve;

**E. Përcaktimi i elementëve të mirëadministrimit duke përcaktuar qartë strukturat përgjegjëse për llogaritjen, dhe vjeljet e detyrimeve.**

## B. Paketa Fiskale 2014-2016

## Kapitulli I: Baza ligjore

### 1) Ligje:

- Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" , Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 9931. date 09.06.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr .9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 10073, datë 09.02.2009 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 10117, datë 23.04.2009, "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar", Ligji nr. 10146, datë 28.9.2009, "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar", Ligji nr. 10354, datë 18.11.2010, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Ligji nr. 10457, datë 21.07.2011 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".
- Ligji nr.9161, datë 18.12.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat " i ndryshuar, Ligji nr.9326, datë 6.12.2004 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar"
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"i ndryshuar".
- Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr.10280, datë 20.5.2010, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar", Ligj nr.10458, datë 21.7.2011, "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, date 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar".

### 2) Vendime dhe udhëzime:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2007 "Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore"
- Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore "

- Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 "Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor"
- Udhëzimi i Ministrit të Financave, nr. 18, datë 23.08.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare" të ndryshuar"

## Kapitulli II: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit, baza e taksueshem, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

### II.1 TAKSA MBI PASURITE E PALUAJTSHME

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron.

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë. Taksa mbi mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

II.1.1 Taksa mbi ndërtesën;
II.1.2 Taksa mbi tokën bujqësore.

### II.1.1 Taksa mbi ndërtesën;

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi.

Kategoritë dhe nënkategoritë. nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën prezantohen si më poshtë vijon.

| Kategoritë dhe nënkategoritë | Lekë/m2/vit |
|---|---|
| **KATEGORIA I. Ndërtesa banimi** | |
| - Ndërtuar para 1993 – shit | 5 |
| - Ndërtua pas 1993 – shit | 6 |
| **KATEGORIA II. Ndërtesa të tjera** | |
| ***Ndërtesa për tregti dhe shërbime*** | |
| - Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore.<br>- Ndërtesa prodhimi<br>- Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj<br>- Të tjera | 75 |
| ***Të tjera*** | |
| - Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve<br>- Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet. | 15 |
| **KATEGORIA III** | |
| - Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike. | 200 |

**Kategoria I. NDËRTESA BANIMI** **Përfshihen**: Të gjitha hapsirat që përdoren për qëllim jo fitimprurës nga banorët vetëm për qëllim banim.

**Kategoria II. NDËRTESA TË TJERA**

**Përfshihen:** ***Nënkategoria ndërtesa për tregti dhe shërbime***

– ***Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore.***
Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat (farmaci, klinika, spitale, maternitete, qëndra shëndetësore të të gjitha specialiteteve dhe njësitë e shërbimit artizanal si marangoz, këpucar, oréndreqës, etj të ngjashme me to). Shkollat, kopshtet, cerdhe, qëndra kulturore, qendra sociale, komplekse sportive, pishina të hapura e të mbyllura, interneti, videoteka të cdo lloji etj të ngjashme me to.

– ***Ndërtesa prodhimi.*** Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore,

prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, nafte etj, shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

– ***Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj të ngjashme me to.*** Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat, hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qëndra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, bankat, zyrat, njësi tregtare dhe shërbimi të cdo lloji etj të ngjashme me to;
– ***Ndërtesa të tjera.*** Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.

*Nënkategoria Të tjera*

– *Ndërtesa të tjera*

*Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve;* Do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare.
*Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet.*

*Do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë kapital i Ndërmarrjeve shtetërore dhe kanë qënë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetëror:*

- Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të cilat jane tërësisht te amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.
- Kur ka qënë objekt i ish- ndërmarrjeve shtetërore të cilat janë privatizuar (tërësisht ose pjesërisht Ndërmarrja ose vetë objekti) dhe është tërësisht i amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të rregjistrura si seli të subjekteve tregtare, Taksa e Pasurisë përllogaritet dhe paguhet si Kategoria II, Ndërtesa të tjera sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë duke u përjashtuar nga Kategoria e I-rë, Ndërtesa Banimi.

**Kategoria III** **Përfshihen:** Të gjithë taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike.

**<u>Mënyra e pagesës:</u>**
Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim ndahet në 2 këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill, kësti i dytë paguhet brenda datës 20 Qershor.

Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

**Lehtësirat tatimore**
Taksapaguesit të cilët paguajnë të gjithë vlerën e detyrimit tatimor vjetor brenda datës 20 Prill, përfitojnë si kusht lehtësues reduktimin në masën prej 6 % të vlerës së detyrimit.

**Përjashtime:**
Përjashtohen nga pagesa e taksës:

- Pronat e shtetit dhe te njesive te qeverrisjes vendore qe perdoren per qellime jofitimprurese, ndretesat e banimit qe shfrytesohen nga qirramaresit me qera te paliberalizuara, ndretesat qe perdoren nga komunitetet fetare.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;**
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për të gjitha kategoritë është Sektori i Taksave pranë Komunës Kallmet.

### II.1.2 Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Taksa mbi tokën bujqësore është një detyrim vjetor. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

| Kategorite e tokes bujqesore | Lekë/ ha / vit |
|---|---|
| I | 3920 |
| II | 3 430 |
| III | 2 940 |
| IV | 2 520 |
| V | 1 680 |
| VI– X | 1 260 |

Taksa mbi pronat e njohura nga komisioni i kthimit pronave. Per personat që i zoterojne këto prona aplikohet taksa sipas natytes së prones, nëse është tokë bujqësore, trajtohen si të tilla nëse janë pyje ose inproduktive sipas ligjeve ne fuqi.

Siperfaqa e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formulari 6, akti I pronësisë, certificatë e regjistrimit të tokës.

**Mënyra e pagesës:**
Detyrimi për taksën mbi tokën është vjetor. Ky detyrim ndahet në 2 këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill, Kësti i dytë paguhet brenda datës 20 Qershor.

**Lehtësirat tatimore**
Taksapaguesit që paguajnë të gjithë vlerën e detyrimit tatimor vjetor brenda datës 20 Prill të vitit, përfitojnë si kusht lehtësues, reduktimin në masën prej 6 % të vlerës së detyrimit.

**Përjashtime**
Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore, vetëm për normën individuale të tokës, individët:

- Invalidët e punës e të luftës;
- Të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si individë;
- Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes

Për të përfituar nga përjashtimi këto familje duhet të paraqesin në zyrën e taksave të komunës, librezën përkatëse ku vërtetohet statusi i tyre si invalid apo verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si individë;

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës**
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për të gjitha kategoritë është Sektori i Taksave pranë Komunës Kallmet.

Ngarkonet Zyra e menaxhimit të tokës pranë Komunës Kallmet për përcaktimin e siperfaqes në pronesi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme. Kjo zyrë informon Sektorin e Taksave pranë Komunës Kallmet sa herë ka ndryshime në sipërfaqe.

## II.2 TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël.

Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, qoftë ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, me anë të të cilit realizohet një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 lekë. **Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël jepen në Aneksin Nr. 1.**

**Mënyra e pagesës:**

Detyrimi i taksës për t'u paguar nga çdo biznes, në çdo vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit, që kryhet në kohën e regjistrimit dhe riregjistrimit të tij,

Detyrimi për taksën mbi biznesin e vogël paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës së Biznesi të vogël**
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së biznesit të vogël është Sektori i Taksave pranë Komunës Kallmet.

## II.3 TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

**Niveli i taksës jepet si më poshtë:**

| Taksa e fjetjes në hotel | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 |
|---|---|---|---|
| Niveli | 3% | 4% | 5% |

**Mënyra e pagesës:**
Pagesa kryhet brënda datës 5 të muajit pasardhës. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli per llogari te komunës dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet cmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës**
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori i Taksave pranë Komunës Kallmet.

## II.4 TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Niveli i taksës sipas kategorive për klasifikimin e investimeve, është si me poshtë:

| KATEGORITË | % |
|---|---|
| Objekte banimi, administrative, shërbimi etj. | 3 |
| Objekte për qëllime publike kopshte, çerdhe, shkolla, spitale (private dhe shtetërore) | 2 |
| Infrastrukturë (private dhe shtetërore ) si : rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefoni etj. | 2 |
| Për ndërtesat në proces legalizimi | 0.5 |

**Mënyra e pagesës:**
Përllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive.

Në rastet kur një ndërtesë ka funksione të përziera (banim dhe administrative etj,përllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive të pjesës së banimit dhe atë administrative, shërbimi etj.

<u>Lehtësirat tatimore</u>
Në rastet kur investitor është Komuna, kjo taksë nuk aplikohet.

Përjashtimisht për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar.

Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

<u>Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës</u>
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori i Taksave pranë Komunës Kallmet.

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Zyra e urbanistikës pranë Komunës Kallmet.

## II.5 TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme aplikohet për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

<u>Mënyra e pagesës:</u>
Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtëshme është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lek/m$^2$ të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

<u>Përjashtimet</u>
Neni 29 i ligjit 9632 datë 30.10.2006 jep të gjiha rastet e përjashtimit nga pagesa e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtëshme.

<u>Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës</u>
Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila në rolin e agjentit të taksës përfitonë 3 % të shumës së arkëtuar, diferenca kalon për llogari të buxhetit vendor jo më vonë se datë 30 e muajit pasardhës.

Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Shkodër te beje rakordimet me ZRPP Shkodër dhe planifikimin e të ardhurave.

## II.6 TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm3 x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit dhe ka zëvendësuar Taksën e rregjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor.

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës;**
Agjenti tatimor për vjeljen e taksës vjetore për mjetet e përdorura është Drejtoria Rrugore e Transportit, e cila i kalon 18 % e vleres se grumbulluar njesise vendore, per mjetet qe jane ne territorin e saj.

Rakordimi pagesës së taksës midis DPSHTRR dhe Zyrës së të Ardhurave kryhet në bazë të rregjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura sipas formatit të përcaktuar në Udhëzim. Procedura e ndarjes së të ardhurave në buxhetin vendor përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

## II.7 TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Baza e taksës për zënie të hapsirave publike është sipërfaqja në m2, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi e dhene me kontratë nga komuna per ushtrim aktivitet biznesi ose siperfaqa rreth ndërtesës e njohur me vendim te këshillit komunes Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Kategoritë dhe nënkategoritë e taksës për zënien e hapësirave publike jepen si në tabelën e mëposhtëme:

| Zënie e hapësirës publike | | Niveli tregues/lek/m2/muaj |
|---|---|---|
| KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË | | **lekë/m2** |
| **a** | Organizimin e spektakleve ose panaireve të ndryshme | 45 |
| **b** | Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi/tregtimi në Tregjet Publike të administruara nga Komuna Kallmet | 45 |
| | *b.1 Artikuj industiral*<br>*b.2 Artikuj të ndryshëm dhe ushqimor* | |
| **c** | Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si: vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma , sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to, sipërfaqe të zëna me antena | 45 |

| | | |
|---|---|---|
| | televizive dhe telefoni, gabina elektrike, nënëstacione, fusha sportive, varreza makinash, pishina etj të kësaj natyre, cadra fushimi, rulota etj të ngjashme me to. | |
| **d** | Hapësira publike për vendosje lojra për fëmijë, hapësira për parking privat, etj | 45 |

**Mënyrat e pagesës:**
Detyrimi i taksës përllogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.

